



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE -SUVA REKA



**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E RREGULLORES, 01-Nr-16-7790 PËR
NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËS/E DHE
STUDENTË/E TË KOMUNËS SË SUHAREKËS**

SUHAREKË -2021



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c) lidhur me nenin 17, të Ligjit, Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008"), e në mbëshhtetje të neneve 15, 27, lidhur, me nenin 28 dhe 29, paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336 i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2021, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES, 01-Nr-16-7790 PËR NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËS/E DHE STUDENTË/E TË KOMUNËS SË SUHAREKËS

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i rregullores, 01-Nr-16-7790 për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës.

Neni 2 Ndryshim-Plotësimi

2.1 Neni 1, i Rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

1 Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës dhe procedurat për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të komunës së Suharekës, të cilët studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës.

2.2 Neni 8, i Rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

8.1 Fëmijët e dëshmorëve të cilët janë studentë dhe nxënës të shkollave të mesme të larta, do të ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, por të gjithë studentët dhe nxënësit e kësaj kategorie janë të obliguar ta sjellin vërtetimin e regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve kur ndahet bursa.

8.2. Kriteret dhe prioritetet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë:

8.2.1 Nota mesatare 9.5 deri në 10.00, në fakultet, vlerësohen me 30 pikë:

8.2.2 Nota mesatare 8.5 deri në 9.49 në fakultet, vlerësohen me 20 pikë:

8.2.3 Nota mesatare 7.5 deri në 8.49 në fakultet, vlerësohen me 15 pikë

8.2.4 Nota mesatare 7 deri në 7.49, në fakultet, vlerësohen me 5 pikë:

8.2.5 Nota mesatare 6 deri në 6.99, në fakultet, vlerësohen me 3 pikë:

8.2.6 Suksesi i shkëlqyeshëm 4.5 deri në 5 në shkollat e mesme të larta vlerësohet me 25 pikë:

8.2.7 Suksesi shumë mirë: 3.5 deri në 4.49 në shkollat e mesme vlerësohet me 15 pikë:

8.2.8 Suksesi i mirë: 3 deri në 3.49 në shkollën e mesme vlerësohet me 8 pikë:



- 8.2.9 Suksesi i mjaftueshem: 2 deri në 2.99 në shkollën e mesme vlerësohet me 3 pikë:
- 8.2.10 Për familjet që kanë 2 (dy) studentë nga e njëjta familje 10 pikë:
- 8.2.11 Për familjet që kanë tre student(vëllezër-motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë të tjera:
- 8.2.12 Për kandidatët e SHML që kanë dy nxënës nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë:
- 8.2.13 Për familjet që kanë tre (3) nxënës në shkollat e mesme të larta (SHML), (vëllezër - motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë:
- 8.2.14 Pikët e studentëve janë të vlefshme vetëm për kategorinë e studentëve dhe pikët e nxënësve llogariten vetëm për kategorinë e nxënësve të të njëjtës familje:
- 8.2.15 Gjendja ekonomike-financiare(rastet sociale) vlerësohen me 30 pikë:
- 8.2.16 Studentët/ nxënësit të cilët nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën pa kritere të përcaktuara në këtë Rregullore, me kusht që ta kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit):
- 8.2.17 Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë, e cila vërtetohet me certifikat të vdekjes ose me deklaratë të bashkësisë familjare:
- 8.2.18 Fëmijët me dy prindërit me nevoja të veçanta me dëshmi mjekësore fitojnë bursën pa kritere të përcaktuara në këtë Rregullore, me kusht që ta kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit):
- 8.2.19 Fëmijët me nevoja të veçanta, ndërsa të dy prindërit janë në gjendje normale vlerësohen me 10 pikë:
- 8.2.20 Fëmijët me njërin prind me nevoja të veçanta dhe vetë fëmija me nevoja të veçanta vlerësohen me 15 pikë:
- 8.2.21 Fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe ish të dënuarve politikë, vlerësohen me 8 pikë:
- 8.2.22 Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së, vlerësohen me 10 pikë:
- 8.2.23 Studentët/et, nxënësit/et të cilët nuk kanë asnjërin prind të punësuar, e cila vërtetohet me dëshmi/vërtetim nga Enti i punësimit dhe nuk krijojnë të ardhura nga ndonjë veprimtari tjetër dobi prurëse, vlerësohen me 15 pikë, por këto pikë nuk llogariten edhe për studentët/et, nxënësit/et, të cilët marrin asistencë sociale:
- 8.2.24 Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 12 pikë,
- 8.2.25 Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 8 pikë.
- 8.2.26 Nxënësit, studentët nga e njëjta familje mund të përfitojnë vetëm një bursë, pa marrë parasysh kategorinë e tyre:
- 8.2.27 Nxënësit/et që kanë poentim të barabartë pas shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë nxënësit/et që kanë distancë më të largët nga institucionet shkollore:

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të Rregullores, 01-Nr-16-7790 për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës, e datës 31.01.2019, mbesin të pa ndryshuara.



Neni 4
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK), Nr-10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr-016/543
Më datë 29-01-2024



[Signature]
Kryesuesi i Kuvendit
Mr. Bexhet KUÇI

REPUBLIKA E KOSOVES